



# Qielli në Tokë

LITURGJIA HYJNORE





Cila ishte ngjarja më e madhe ku keni marrë pjesë në jetën tuaj?



**A** ishte një koncert ose një ngjarje sportive? A ishte një festë familjare ose një dasmë? Ndërsa po kërkonit për të gjetur përgjigjen, a menduat për Liturgjinë Hyjnore?

Fjala “*hyjnore*”, do të thotë se në këtë ngjarje ka diçka ndryshe. Askush nuk do ta quante *hyjnore* një ndeshje sportive ose një koncert. *Hyjnore* do të thotë diçka nga Perëndia. Prandaj, Liturgia Hyjnore është ndryshe nga të tjerat.

Fjala “liturgji” vjen nga dy fjalë të greqishtes së vjetër, *leitōs* (njerëz) dhe *ergon* (punë, vepër). Liturgji do të thotë punë e popullit. Fjala liturgji (*leiturgia*) përdorej për të treguar një shërbim të ndërmarrë nga një qytetar për të mirën e përbashkët të njerëzve. Me fjalë të tjera, Liturgia Hyjnore është një “punë e përbashkët”, që ndodh për dobinë e njerëzve në mënyrë të tillë që të tregohet kujdes për njerëzit e Perëndisë nëpërmjet veprës së Tij. Në këto “shërbesa” ne i shërbejmë Perëndisë nëpërmjet punës sonë në Liturgjinë Hyjnore.

Perëndia kujdeset për gjithë krijesën dhe dëshiron të jetë me njerëzit për të cilët ka dashuri. Ai dëshiron të rrënjosë brenda nesh shpresë dhe dashuri për Të; dhe ne dëshirojmë Ta adhurojmë dhe Ta falënderojmë Atë për gjithçka që ka bërë dhe bën për ne. Kjo ndodh në çdo shërbesë adhurimi të Kishës, por veçanërisht në Liturgjinë Hyjnore.





**N**e nuk e dinim nëse ishim në qiell a në tokë, sepse në tokë nuk ka aq shumë madhështi dhe bukuri; dhe nuk gjejmë fjalë për ta përshkruar. Dimë vetëm se Perëndia banon aty midis njerëzve, dhe se shërbesa e tyre është më e nderuar se ceremonitë e kombeve të tjera, sepse ne s'mund ta harrojmë atë bukuri".

Sipas traditës, ky citim daton në vitin 987 pas Krishtit. Princi Vladimir i Keivit (një qytet në Ukrainën e sotme) donte të zgjidhte besimin për popullin e tij. Ai dërgoi grupe njerëzish të vizitonin qytete dhe fe të ndryshme. Një grup vizitoi Kostandinopojën dhe ndoqi Liturgjinë Hyjnore në Kishën madhështore të Urtësisë së Shenjtë, në Shën Sofi. Grupi u kthye në Kiev dhe i raportoi princit atë që kishte përjetuar. (Në pikturën e mëposhtme, princi dëgjon raportin nga Kostandinopoja.) Prej këtij raportimi, princi Vladimir vendosi që populli i tij të ishte i Krishterë Orthodhoks.

Mendoni për këtë. Vladimiri kishte pasuri dhe pushtet. Ai jetonte një jetë të rehatshme, një lloj jete që e lejonte të shihte gjithë bukuritë e bëra nga njeriu dhe të gjente gjithë kënaqësitë në botë. Megjithatë, ai ende nuk e kishte përjetuar kurrë llojin e bukurisë, që të dërguarit e tij i kishin përshkruar.

# Qielli në Tokë

Çfarë kuptojmë kur themi, qielli takon tokën? Që t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje duhet të kujtojmë si ka vepruar Perëndia përgjatë historisë. Së pari, ne besojmë se Perëndia krijoi "gjithçka të dukshme dhe të padukshme". Së dyti, Perëndia na do aq shumë sa "Ai dha Birin e Tij të vetëm" që të kemi jetë të përjetshme (Joani 3:16). Së treti, Perëndia është gjithmonë me ne, sepse Ai na dërgon Shpirtin e Tij të Shenjtë. Bibla është e mbushur me shumë imazhe të Perëndisë. Një imazh i tij është ati në parabolën e Djalit Plangprishës. Ne besojmë që Perëndia dëshiron të ketë një marrëdhënie të ngushtë me bijtë e Tij, edhe pse shumë prej tyre nuk gjejnë kohë për të kaluar me Të.



Jisui thotë: "Sepse atje ku janë të mbledhur dy a tre veta në emrin tim, unë jam aty mes tyre" (Mattheu 18:20). Ne besojmë që Zoti Jisu Krisht është i pranishëm në Liturgjinë Hyjnore. Mënyra si ndodh kjo, si vjen qielli në tokë, është ajo që ne e quajmë *myster*, diçka përtej asaj që mund të kuptojmë. Ne e dimë

që kur vijmë të takojmë Perëndinë në Liturgjinë Hyjnore, Ai është i pranishëm mes nesh. Edhe pse Krishti është i padukshëm për syrin tonë, ne përjetojmë praninë e Tij.

Liturgjia Hyjnore nuk është një vënie në skenë e diçkaje, një spektakël ose një shfaqje teatrale. Në thelb, ajo është diçka për Perëndinë dhe për njerëzit. Krijuesi dhe krijesat kalojnë kohë së bashku. Besimtarët adhurojnë dhe falënderojnë Perëndinë dhe Ai ofron veten e Tij nëpërmjet Kungimit të Shenjtë. Mund të kaloni kohë me Perëndinë edhe në shtëpi, por Perëndia dëshiron që familja e Tij e madhe (i gjithë komuniteti) të jetë së bashku. Kjo gjë realizohet në Liturgjinë Hyjnore. Kur marrim pjesë në Liturgjinë Hyjnore, jemi thirrur të përfshihemi në mënyrë aktive. Ne jemi bashkëpunëtorë në "punën e popullit".

**Në Bibël ka shumë imazhe të tjera të Perëndisë. Shih referencat e mëposhtme:**  
Eksodi 3:6  
Psalmi 3:3  
Psalmi 24:8  
Mattheu 23:37  
Joani 4:24

# Liturgjia Hyjnore në Kishën e hershme

**D**isa herë njerëzit mendojnë se Liturgjia Hyjnore ra nga qielli dhe se kryhet saktësisht në të njëjtën mënyrë që nga koha e apostujve të Krishtit e deri më sot. Kjo nuk është e vërtetë. Ashtu si shumë gjëra në Kishën tonë, zhvillimi i saj ishte një proces që ndodhi përgjatë shekujve. Ne dimë nga disa shkrime të hershme të Kishës se të krishterët takoheshin rregullisht dhe vepronin kështu: luteshin, lexonin dorëshkrime rreth Krishtit (sepse Dhiata e Re nuk ishte shkruar ende), dhe kujtonin Darkën e Fundit, kur Krishti filloi Eukaristinë.

Shën Justin Martiri (100-165) shkroi këtë përshkrim të Liturgjisë Hyjnore për romakët që nuk ishin të krishterë:

Dhe ditën e quajtur e dielë mblidhen në një vend ata që jetojnë në qytet ose në fshat dhe aty kujtimet e apostujve ose shkrimet e profetëve lexohen aq gjatë sa e lejon koha. Kur lexuesi ka mbaruar, kryetari, me një fjalim, na nxit dhe na fton t'i imitojmë këto gjëra fisnike. Pastaj ne ngrihemi dhe bëjmë lutje bashkë. ...kur kemi mbaruar lutjen, sillet buka, vera e uji dhe po ashtu kryetari drejton lart lutje e falënderime duke përdorur sa më mirë aftësitë e tij dhe komuniteti pohon duke thënë: Amin. Pastaj bëhet ndarja dhe marrja e gjërave të shenjtëruara nga secili dhe ato, me anën e dhiakëve, u dërgohen atyre që mungojnë. Ata që dëshirojnë, kontribuojnë sipas mundësisë. Ato që mblidhen i jepen kryetarit dhe ai kujdeset për jetimët, gratë e veja... shkurt ai është mbrojtësi i tërë atyre në nevojë. (Justin Martiri, Apologjia I)

**Për përshkrimin më të vjetër të Darkës së Fundit në Dhiatën e Re, lexo I Korintasve 11:23-26.**

Nga kjo mund të shohim një version të strukturës së Liturgjisë Hyjnore. Ndërsa Krishtërimi po përhapej dhe po rritej, Kisha e mbajti këtë strukturë të të kremtuarit të Liturgjisë, por i shtoi asaj më shumë gjëra. Gradualisht, u zhvilluan forma të ndryshme të Liturgjisë. Shumë shpejt pati mënyra të ndryshme të kremtimit të Liturgjisë në rajone të ndryshme të Kishës së krishterë. Çdo rajon ruante strukturën e përgjithshme, por kishte mënyrën e tij për ta shprehur. Shpesh këto kremtime të ndryshme i quajmë “rite”.

*Liturgjia Hyjnore, siç e kemi sot, filloi të marrë këtë formë në shek. IV dhe u zhvillua përgjatë shumë shekujve. Ky dorëshkrim i Liturgjisë Hyjnore të Shën Vasilit të Madh u kopjua me dorë dhe u dekorua rreth vitit 1300. Figura këtu tregon Antifonet.*



# SHËN SOFIA

Nga ana verilindore qëndron ajo që quhet **SKEVOFILAKION**, një strukturë e vogël rrethore, e ndërtuar ndoshta shumë vjet para ndërtimit të Shën Sofisë. Njerëzit linin aty dhuratat e tyre, bukën dhe verën, para se të shkonin në Kishë. Dhiakët shkonin në Skevofilakion, që të merrnin ofertat dhe t'i përgatitnin ato për Kungimin e Shenjtë. Ata ktheheshin me Kupën, Dhiskun, temjanin, gjashtë krahëshet, dhe qirinjtë, diçka praktike dhe e thjeshtë që u zhvillua në procesionin e hollësishtë të Hyrjes së Madhe.

Në Kishën e Madhe, **SHENJTËRORJA** ishte e rrethuar nga një pengesë e ulët, që ndante zonën ku qëndronin vetëm priftërinjtë nga Nefi (pjesa ku qëndronin njerëzit). Shenjtërorja nuk ishte fshetur pas Ikonostasit dhe Dyerve Mbretërore, zakon ky që filloi shumë më vonë.

Pjesa e sipërme, kolonat, dhe baza e Tryezës së **ALTARIT** ishin të gjitha prej ari, rregulluar me gurë të çmuar.

**FRONI I SHENJTË**  
(ndenjësja e episkopit)  
gjendej pas Altarit.

**AMVONA** ishte një strukturë shumë e madhe në formë vezake që qëndronte në majë të kolonave, afër qendrës së Nefit. Ajo ishte mjaft e gjatë, që psaltët të qëndronin poshtë.

Një korridor, i quajtur **SOLEA**, lidhte Amvonën me Shenjtëroren, duke u mundësuar folësve dhe lexuesve të kalonin përmes turmës në një kishë të mbushur plot.

**P**ër më shumë se 1000 vjet, nga shek. IV deri në shek. XV, Kostandinopoja ishte kryeqyteti i Perandorisë Romake. Katedralja në kryeqytet ishte Kisha e Madhe e Shën Sofisë, ndërtuar nga perandor Justiniani në vitet 550.

Të krishterët kishin kremtuar Liturgjinë Hyjnore për disa shekuj, para se Justiniani të ndërtonte kishën e madhe. Strukturat e brendshme bazë të saj, si Amvona dhe Shenjtërorja, ishin modeluar sipas modeleve të kishave ekzistuese. Risitë erdhën me arkitekturën e përgjithshme të ndërtesave. Më vonë, ndërtuesit e kishave e admiruan bukurinë dhe madhësinë e kubesë, e cila përfaqësonte qiellin, si dhe përdorimin e dritës dhe hapësirën brenda kishës.

Mënyra si kremtohej Mesha Hyjnore në Shën Sofi ndikoi në mënyrën si ajo kremtohej kudo në Perandorinë Romake. Deri në shek. IX, Liturgjia kishte marrë një formë që mund të dallohej, megjithëse vazhdoi të ndryshonte, që të plotësonte nevojat e Kishës dhe të njerëzve në kohë të ndryshme. Për shembull, Liturgjisë dhe shërbesave të tjera adhuruese orthodhokse iu shtuan himne, kështu që pati kompozime të reja muzikore.

**Një term i rëndësishëm për të kuptuar Liturgjinë është termi "rit". Një rit është një akt solemn, ceremoni ose procedurë që ndjek zakonin ose mënyrën e një komuniteti të veçantë, zakonisht fetar.**

**K**isha, ashtu siç dëshiron që ne të lutemi çdo ditë, kështu edhe vetë ka ritmin e saj ditor të lutjes. Dita kishtare fillon me perëndimin e diellit dhe mbaron po me perëndimin e tij. Ndërsa dita kalendarike fillon në mesnatë dhe mbaron po në mesnatë. Dita kishtare fillon me shërbesën e Mbrëmësore së ditës së mëpasshme. Nëse të nesërmen do të ketë Liturgji Hyjnore, bëjmë Mbrëmësore të Madhe, nëse jo, bëjmë atë që e quajmë “Mbrëmësore e Vogël”. Mbrëmësorja fillon me leximin e Psalmi 103 dhe këndimin e Psalmi 140. Një himn i rëndësishëm në Mbrëmësore është: “O dritë gazmore...”, që e këndojnë të gjithë. Mbrëmësorja përfshin edhe himne e lexime rreth shenjtoreve, periudhave dhe ngjarjeve të tjera që festohen.

Çdo mëngjes Kisha bën Mëngjesoren, pavarësisht nëse kjo do të ndiqet nga Liturgjia Hyjnore ose jo. A keni arritur ndonjëherë në Kishë para se të fillojë Liturgjia Hyjnore? Ajo që po bëhej ka qenë Mëngjesorja. Mëngjesorja celebrhet në kohën e lindjes së diellit.

Mëngjesorja fillon me leximin e gjashtë psalmeve dhe përfshin shumë himne rreth shenjtimit, periudhës ose ngjarjeve të tjera që festohen atë ditë. Shërbesa mbaron me Dhoksologjinë e Madhe, e cila është një himn që lavdëron Perëndinë. Në ditët kur Mëngjesorja paraprin Liturgjinë Hyjnore, mund të shihni priftin duke lexuar lutje për të përgatitur veten për Liturgjinë Hyjnore. E shohim priftin edhe duke përgatitur bukën dhe verën, që do të ofrohen dhe shenjtërohen gjatë Liturgjisë. Kjo shërbesë është Proskomidhia.

## GJËRAT QË SHIHEN NË LITURGJINË HYJNORE

### NJERËZIT

Zoti tha se kur dy veta janë mbledhur në emërin tim, Ai është aty në mes tyre. Pjesa më e rëndësishme e Liturgjisë janë njerëzit. Të gjithë jemi bashkëpunëtorë. Që të kryhet Liturgji Hyjnore duhet të ketë prift dhe njerëz që marrin pjesë në të. Prifti nuk mund të celebrtojë Liturgjinë për veten e tij ose nëse askush nuk është i pranishëm.

Psaltët ose kori drejtojnë popullin gjatë këndimit. Disa herë kori ose psaltët këndojnë himnet me radhë, herë njëri herë tjetri, por është e rëndësishme të dimë që të gjithë duhet të këndojnë. Gjithashtu, pjesëtarë të enorisë ndihmojnë komunitetin për të mbajtur rregull, për të mbledhur gjërat që ofrohen, për të shpërndarë librat dhe për detyra të tjera.





# Fillimi i Liturgjisë

**D**uhet të arrijmë në kohë për Liturgjinë Hyjnore dhe të hymë në Kishë me qetësi dhe plot respekt. Në fund të fundit, kur kemi bileta për një ndeshje sportive, koncert ose film, kujdesemi të jemi të përgatitur dhe të arrijmë herët.

Në Narteksin e Kishës, ndezim një qiri, i dhurojmë ofertën Kishës, themi një lutje dhe nderojmë ikonat. Oferta që i ofrojmë Kishës janë të holla të cilat ajo i përdor për shpenzimet e saj ose për të ndihmuar të varfrit. Kjo ofertë nga jeta jonë është një pjesë e rëndësishme e adhurimit. Fakti që bëjmë këto gjëra na ndihmon të përgatitemi për shërbesën.

**VINI RE!** Prifti bën shenjën e kryqit me librin e Ungjillit, i cili përmban fjalët e Krishtit.

**DËGJONI!** Prifti këndon: “E bekuar është Mbretëria e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve”.

**ÇFARË TË BËNI?** Kur prifti fillon Liturgjinë, bëni shenjën e kryqit. Ne bëjmë shenjën e kryqit shumë herë, por veçanërisht kur themi një lutje ose fillojmë një Litani, kur fillojmë ose përfundojmë një veprim të caktuar, para dhe pas vakteve të ngrënies dhe në fillim e në fund të çdo dite.

**LUTUNI!** Disa herë kjo është e vështirë të bëhet, por i kushtoni vëmendje fjalëve të Liturgjisë. Dëgjojini me kujdes, se ju thonë për çfarë të luteni dhe mendoni për kuptimin e lutjeve. Përpiquni shumë, që të përqendrohemi në Liturgji. Shumë njerëz shpërqendrohen shpesh, sepse mendojnë çfarë do të bëjnë pas Liturgjisë Hyjnore.

**SHKRIMI I SHENJTË** E bekuar është Mbretëria ... (Marku 11:10) e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit të Shenjtë (Matheu 28:19).

Proskomidhia është Tryeza ku bëhet përgatitja e bukës dhe e verës (e Dhuratave të Shenjta). Ajo është e vendosur në të majtë të Tryezës së Altarit në Shenjtërore dhe zakonisht është e ndërtuar në mur.

## PROSKOMIDHIA

## KLERI

Drejtuesi i zakonshëm ose kremtuesi i Liturgjisë Hyjnore në enorinë tuaj është prifti, por kur është i pranishëm episkopi, e drejton ai kremtimin. Në disa enori, mund të ketë edhe një dhiak, i cili ndihmon meshtarin. Ju do të shihni edhe djemtë e Altarit, të cilët ndihmojnë meshtarin.





**A**i keni kërkuar ndonjëherë babait tuaj të bëjë diçka për ju? Sigurisht që po. Të gjithë ne kemi nevoja dhe dëshira. Në Liturgjinë Hyjnore, Litanian është një seri ose një listë e shkurtër lutjesh ose kërkesash.

Nëse shihni me kujdes kërkesat, do të vini re që ato përfshijnë shqetësimin për problemet e secilit, jo vetëm të të krishterëve orthodhoksë. Gjeneri një moment dhe lexoni kërkesat në një libër të shërbesës së Liturgjisë Hyjnore. Çfarë kërkojnë ato?

Kërkesa e parë e vendos theksin te ne: “Me paqe le t’i lutemi Zotit”. Kjo kërkesë është si një ftesë që ta fillojmë lutjen tonë me paqe. Ç’do të thotë të lutemi me paqe? Duhet të lutemi qetësisht dhe pa shpërqendrim, por të përqendruar në shqetësimin tonë për botën. Perëndia ynë është Perëndia i paqes. Shën Nikolla Kavasila, që jetoi në shek. e XIV, tha: “Kushdo që lutet pa paqe të brendshme, nuk lutet mirë”.

# Paqësoret

**VINI RE!** Kush i lexon ose i këndon lutjet? Disa herë këtë e bën prifti, disa herë dhiaku. Në shumicën e enorive është zakonisht prifti ai që i lexon ato. Mund ta dalloni dhiakun nga veshjet e tij. Ai qëndron jashtë Shenjtërores për të thënë Litaninë. Kur prifti lexon ose këndon Litaninë, ai qëndron brenda Shenjtërores (Ajomimës), përpara Altarit.

**DËGJONI!** Dëgjoni referimin për Virgjëreshën Mari. Fundi i Litanive ose i një serie himnesh mbaron gjithmonë me një lutje drejtuar Hyjlindëses.

**LUTUNI!** Ndërsa prifti lexon çdo kërkesë, mendoni për njerëz ose situata që mund të përfitojnë nga ndihma e Perëndisë. Pyetni veten nëse ka diçka që mund ta bëni për t’i ndihmuar ata. Nëse vini re me kujdes, do të shihni që nuk lutemi vetëm për njerëzit, por edhe për kohë të mirë, madje edhe për forcat e armatosura.

**A E DINIT?** Çdo Litani përfundon me “Amin”, që do të thotë “ashtu u bëftë”.

**SHKRIMI I SHENJTË** Po ju jap paqen time... . Le të mos tronditet dhe të mos frikësohet zemra juaj. (Joani 14:27)

Kërkoni paqe me të gjithë njerëzit... (Hebrenjtë 12:14)



## TRYEZA E ALTARIT

Kjo është një Tryezë mbi të cilën, gjatë shërbesave adhuresive, vendoset oferta për Perëndinë. Buka dhe vera, gjatë Liturgjisë Hyjnore, çohen nga Proskomidia në Tryezën e Altarit, që t’i ofrohen Perëndisë.



# Antifonet

**VINI RE:** Nëse prifti nuk është duke kënduar ose duke psalur, kjo nuk do të thotë se po bën pushim. Ai po lutet në heshtje. Këto urata dikur lexoheshin me zë të lartë, por tani disa i bëjnë me zë të ulët.

**DËGJONI!** Kur një varg ose Antifon psalet ose këndohet tri herë, shpesh kur këndohet për herën e tretë ka një ndryshim.

**ÇFARË TË BËNI?** Bashkë me pjesën tjetër të komunitetit këndoni: “Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u ngjalle prej së vdekurish, ne që të psalim. Alilua”.

**LUTUNI!** Gjatë këndimit të Antifonit të parë, lutjuni Hyjlindëses të ndërmjetojë për të gjithë ne. Gjatë këndimit të Antifonit të dytë, drejtojini Krishtit një lutje.

**A E DINIT?** Psalmet janë poema ose lutje në Dhiatën e Vjetër në Bibël. Ato u shkruan nga mbreti David, rreth 1000 vjet para Krishtit.

Himni: “O i Vetëmlindur Bir...”, që këndohet ndërmjet Antifonit të dytë dhe të tretë është përmbledhje e Besores.

## SHKRIMI I SHENJTË

Beko Zotin, o shpirti im!  
Dhe ti, o zemra ime, beko emrin e Tij të shenjtë!  
Beko Zotin, o shpirti im dhe mos harro tërë mirësitë e Tij.  
Atë që fal gjithë paudhësitë e tua, atë që shëron gjithë sëmundjet e tua... (Psalmi 103)



ANDIMINSI

Andiminsi është një pjesë rrobe që është bekuar nga episkopi gjatë shenjtërimit të një kisha. Episkopi e firmos Andiminsin. Në të është një ikonë e Krishtit të shtirë në varr. Andiminsi ka edhe katër ungjillorët të stampuar nëpër cepa. Meshtari, gjatë Liturgjisë Hyjnore, vendos Potirin dhe Dhiskun mbi Andimins. Andiminsi vendoset zakonisht mbi Altar, por mund të kryhet Liturgji Hyjnore në një Andimins, edhe kur nuk ka Altar.

Në fillimin e Liturgjisë Hyjnore këndojmë dy grupe Antifonësh. Antifonet janë himne ose vargje nga Psalmet ose nga libra të tjerë të Shkrimit të Shenjtë, që ndiqen nga një refren. Antifonet u krijuan për t'u kënduar me radhë nga dy psaltë të ndryshëm ose nga dy kore. Antifone literalisht do të thotë “këndim me dy kore”. Mënyra antifonike e të kënduarit të psalmeve, të himneve ose të këngëve është shumë e vjetër. Ajo praktikohet nga hebrenjtë gjatë kohës së Dhiatës së Vjetër. Shumë enori sot këndojnë vetëm refrenet.



YLLI DHE DHISKU

Dhisku është një pjatë në të cilën vendoset pjesa e Bukës së Meshës, që do të shenjtërohet si Trupi i Krishtit. Ylli është një kornizë metalike që vendoset mbi Dhiskun. Ylli nevojitet që të mbajë Mbulesën e Bukës mbi Dhisk.



# Hyrja e Vogël

**G**jatë Liturgjisë Hyjnore ndodhin dy Hyrje. Hyrja e Vogël vjen pas Antifoneve. Prifti, duke mbajtur librin e Ungjillit në dorë, bën një procesion jashtë Shenjtërores. Zakonisht, ai paraprihet nga djemtë e Altarit që mbajnë qirinj. Qirinjtë janë të ndezur, jo sepse është errësirë, se në Kishë ka mjaft dritë, por për të shprehur gëzim. Shekuj më parë, qirinjtë ishin shenjë treguese e afrimit të një personi të rëndësishëm. Qirinjtë paraprijnë Hyrjen e mbretit. Kush mendoni ju se është mbreti që po hyn në Hyrjen e Vogël?



**VINI RE!** Nëse shërben një dhiak, ai shoqëron priftin dhe mban librin e Ungjillit.

**DËGJONI:** Gjatë Liturgjive të ditëve të javës, në vend që të këndojmë: "... që u ngjalle së vdekurish", gjatë Antifonit të dytë dhe himnit të Hyrjes, këndojmë: "... o i çuditshëm ndër shenjtorët".

**ÇFARË TË BËNI?** Gjatë secilës Hyrje, ngrihuni në këmbë, sepse ajo që ndodh është e rëndësishme. Nëse një mbret do të hynte në dhomë, nuk do të qëndronit ulur. Kur prifti thotë: "Kryet tanë le t'ia ulim Zotit," ulni kokën, si një shenjë respekti për mbretin.

**LUTUNI!** Lutuni që Perëndia të shpëtojë popullin e Tij.

**A E DINIT?** Shekuj më parë Hyrja e Vogël ishte fillimi i Liturgjisë, e cila fillonte në hyrje të kishës.

## SHKRIMI I SHENJTË

Ejani, t'i këndojmë me gëzim Zotit, t'i dërgojmë britma gëzimi kalasë së shpëtimit tonë. Le të shkojmë në prani të Tij me lavde, ta kremtojmë me këngë. (Psalmi 95:1-2)

## POTIRI

Potiri është një kupë që mban Kungatën e Shenjtë. Ai na kujton kupën që Krishti përdori në Darkën e Fundit.





# Trishenjti

**T**rishenjt literalisht do të thotë “tri herë i shenjtë”. Kjo është një lutje trefishe që nderon Shën Trininë. Shumica e shërbesave të lutjeve në Kishën tonë fillon me: “Shenjt Perëndi”. Ne vijmë në Kishë, t’i këndojmë këtë himn Perëndisë, duke adhuruar Trininë e Shenjtë, një Perëndi në tre persona, Atë, Bir dhe Shpirt i Shenjtë.

## Historia e Trishenjtit

Trishenjt, sipas Traditës Orthodhokse, i ka gjurmët në mesin e shek. V. Gjatë kohës së Shën Proklit, patriarkut të Kostandinopojës, qyteti u trondit nga një tërmet dhe njerëzit u arratisën nga qyteti. Atje, jashtë qytetit, iu përgjëruan Perëndisë për ndihmë. Ndërsa po luteshin, një djalë i vogël u mor nga një engjëll lart në ajër mbi të gjithë njerëzit. Kur u kthye në tokë, ai u tha atyre se pa edhe dëgjoji engjëjt duke kënduar himnin trishenjtor para fronit të Perëndisë. Menjëherë, populli dhe kleri filluan të këndonin këtë himn dhe tronditjet e tërmetit u ndalën. Shpejt pas kësaj ngjarjeje, ky himn iu bashkua Liturgjisë Hyjnore, aty ku gjendet deri më sot.

## MESHA

Mesha, Buka e përdorur për Liturgjinë Hyjnore, përgatitet me kujdes dhe me lutje. Njerëzit bëjnë Bukën dhe ia ofrojnë Kishës. Fjala greke për meshën **prosforo** do të thotë “ofertë”.

**DËGJONI!** Herën e tretë himni duhet të këndohet me zë më të lartë. A mund vini re ndryshimin?

**LUTUNI!** Lutuni Trinisë të ketë mëshirë për ne. Mendoni sa madhështor është Perëndia!

**VINI RE!** Gjatë këndimit të Trishenjtit, prifti i përsërit fjalët me zë të ulët dhe përulet para Proskomidhisë. Pastaj ai kthehet nga ana e pasme e Shenjtërores, drejt vendit ku ulet episkopi në këtë moment të Liturgjisë, nëse është i pranishëm, dhe përulet përsëri.

**ÇFARË TË BËNI?** Bëni shenjën e kryqit, sepse po përmendim Trininë. Këndoni bashkë me psaltin ose korin.

**A E DINIT?** Sipas profetit Isaia, Trishenjt është himni i kënduar nga engjëjt para Perëndisë në qiell: “Unë pashë Zotin, të ulur në një fron... Mbi të qëndronin Serafimet... Dhe njëri i thërriste tjetrit dhe i thoshte: Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Savaoth, qielli e dheu është plot me lavdinë e Tij!” (Isa 6:1-5)

## SHKRIMI I SHENJTË

I shenjt, i shenjt, i shenjt është Zoti Perëndia i gjithëfuqishëm, që ishte, që është dhe që po vjen! (Zbul 4:8)





# Apostulli



**A** i ruan ti letrat e rëndësishme ose mesazhet? Apostulli është një letër. Në Dhiatën e Re, Apostulli i referohet letrave të Shën Pavlit dhe apostujve të tjerë, si Jakovit dhe Joanit.

**ÇFARË TË BËNI?** Gjatë leximit të Apostullit duhet të jeni të vëmendshëm. Disa herë është mirë që t'i hidhni një sy në shtëpi dhe ta lexoni më me kujdes. Nëse keni Biblën me vete, mund ta lexoni Apostullin bashkë me lexuesin.

**DËGJONI!** Dëgjoni kur lexuesi thotë emrin e letrës dhe shkruetin e saj.

**VINI RE!** Kur lexuesi ka mbaruar leximin, prifti e bekon dhe ai i puth dorën.

**A E DINIT?** Shën Pavli u dërgoi letra kishave të para të krishtera, që ato të mund t'u lexoheshin me zë të lartë të gjithë pjesëtarëve të enorisë. Shihni Kol. 4:6 për të gjetur udhëzimet e Shën Pavlit rreth leximit të letrave të tij.

Në shekujt e hershëm të Kishës, para leximit të Apostullit, bëhej një lexim nga Dhiata e Vjetër.

## SHKRIMI I SHENJTË

Të shkrova se kam besim që do të më dëgjosh dhe e di që do të bësh edhe më shumë nga ato që po të them. (Filemoni 1:21)



## LIBRI I UNGJILLIT

Ungjill do të thotë “Lajm i Mirë”. Libri përmban leximet nga Matheu, Marku, Lluka dhe Joani, një pjesë e të cilëve lexohet në çdo Liturgji Hyjnore. Ungjilli mbahet gjithmonë mbi Tryezën e Shenjtë në Kishë.



**N**ë vazhdim, pas Apostullit prifti lexon një pjesë nga Ungjilli. Leximi nga Ungjilli, ashtu si edhe leximi nga Apostulli, ndryshon çdo ditë. Ungjilli na tregon për jetën e Jisuit, për mësimet e Tij dhe për mrekullitë që Ai bëri. Ungjilli, ashtu si dhe leximi i Apostullit, na mëson dhe na frymëzon me Lajmin e Mirë të dashurisë së Perëndisë për të gjithë ne.



**ÇFARË TË BËJMË?** Kush mundet qëndron në këmbë dhe i kushton vëmendje leximit të Ungjillit. Madje edhe episkopi e dëgjon Ungjillin bashkë me njerëzit.

**DËGJONI!** Kur prifti është afër fundit të leximit, ai fillon ta këndojë atë ndryshe.

**VINI RE!** Prifti bën shenjën e kryqit me librin e Ungjillit, që të bekojë njerëzit.

**A E DINIT?** Disa herë leximet përbëhen nga pasazhe ose nga vargje të shkëputura nga një Ungjill. P.sh. leximi mund të kapërcejë disa vargje që nuk lidhen drejtpërdrejt me temën e festës ose me periudhën. Leximet për Kalendarin Kishtar u vendosën në shek. X.

### **SHKRIMI I SHENJTË**

Dhe ja, një engjell i Zotit iu shfaq atyre dhe lavdia e Zotit i mbështolli me dritë. Ata u trembën shumë, por engjëlli iu tha: “Mos kini frikë! Ja, po ju jap lajmin e mirë, një gëzim të madh për të gjithë popullin”. (Lluka 2: 9-10)

### **QIRINJTË**

Ndezim qirinj që të theksojmë se Krishti është drita e botës.





# Predikimi

**P**redikimi quhet edhe homeli. Predikimi shpjegon leximin nga Ungjilli ose nga Apostulli. Na mëson rreth besimit dhe si duhet të përpiqemi të jetojmë jetën tonë në përputhje me të. Në shekujt e hershëm të Krishtërit, meqë shumë nga njerëzit nuk dinin të lexonin, predikimi ishte mënyra kryesore për të mësuar pjesëtarët e Kishës. Sot, edhe pse shumë njerëz kanë Biblën e tyre personale dhe libra të tjerë për besimin, predikimi vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm. Sipas traditës, predikimi duhet bërë menjëherë pas leximit të Ungjillit të cilin shpjegon.



**ÇFARË TË BËNI?** Dëgjoni priftin. Mendoni si t'i përfshini ato që ai thotë në jetën tuaj. Predikimi mbi Ungjillin bëhet zakonisht në mënyrë të tillë, që të jetë i mundur zbatimi i tij në jetën e përditshme, si për një të ri, ashtu edhe për një të moshuar.

**A E DINIT?** Në Kishën e hershme predikimet ishin shumë të gjata. Për shembull, thuhet që Shën Joan Gojarti predikonte për orë të tëra dhe njerëzit donin që ai të fliste edhe më shumë.

## SHKRIMI I SHENJTË

Prediko fjalën e Perëndisë me këmbëngulje dhe në çdo kohë, korrigjo, qorto dhe këshillo duke i mësuar të tjerët me shumë durim. (2 Tim 4:2)



## TEMJANICA

Kjo është një enë në të cilën digjet temjani. Është e thjeshtë të dallosh një temjanicë, sepse nuk ka asgjë tjetër që të duket krejtësisht si ajo. Një temjanicë ka tre zinxhirë dhe zakonisht 12 zile të vogla që lidhen me zinxhirët.

## TEMJANI

A ndieni një aromë të këndshme ose shihni tym disa herë gjatë Liturgjisë? Është temjani që digjet në temjanicë. Temjani bëhet nga rrëshirat, si lëng pemësh, të cilit i shtohet aromë. Temjan iu dha Krishtit nga njëri prej Magëve. Temjani na kujton lutjen. Kur lutemi, lutja jonë ngjitet te Perëndia, ashtu si ngrihet tymi.



# Himni Keruvik dhe Hyrja e Madhe

**H**yrja e Madhe është një procesion solemn. Dhuratat nga populli, të përgatitura për t'iu ofruar Perëndisë, d.m.th. buka dhe vera, merren nga Proskomidhia dhe pastaj vendosen në Tryezën e Altarit. Këto dhurata do t'i ofrohen së shpejti Perëndisë për transformim në Trup dhe Gjak të Krishtit. Mbani mend: Gjatë Hyrjes së Madhe dhuratat nuk janë



Trupi dhe Gjaku i Krishtit, ato janë thjesht dhurata të përgatitura për t'iu ofruar Perëndisë.

Pjesën e parë të Himnit Keruvik e këndojmë para

Hyrjes së Madhe, ndërsa pjesën e dytë e këndojmë pasi prifti i ka vendosur dhuratat në Tryezën e Altarit.

Lexoni me kujdes pjesën e parë të himnit. Si na kujton himni të bëhemi? Pjesa e dytë e himnit ka të bëjë me shpërblimin që do të kenë ata që i shërbejnë dhe e lavdërojnë Perëndinë; ata do të mirëpresin Mbretin e Universit në Ardhjen e Tij të dytë.

## AJRI

Ajri është një pëlhurë që mbulon edhe Potirin edhe Dhiskun. Ai, gjatë Hyrjes së Madhe, vendoset mbi supet e priftit. Ka edhe mbulesa më të vogla për Potirin dhe Dhiskun.

**VINI RE!** Para procesionit dhe gjatë këndimit të Himnit Keruvik, prifti temjanis popullin.

**ÇFARË TË BËNI?** Kur prifti temjanis pjesën e kishës, ku jeni dhe ju, bëni shenjen e kryqit dhe ulni kryet.

**LUTUNI!** Lutuni që vetëm për një moment të mund të “largoni prej jush tërë kujdesin për jetën” dhe të përqendrohni në gjërat qiellore.

**A EDINIT?** Një keruvim është një lloj engjëlli. Në Traditën Orthodhokse ka nëntë rangje engjëllorë: Serafimet, Keruvimet, Fronet, Zotërimet, Pushtet, Fuqitë, Principatat, Kryeengjëjt, Engjëjt.

## SHKRIMI I SHENJTË

Dëgjo, o bari i Izraelit, që udhëheq Jozefin si një kope, ti që rri mbi Keruvimet, shkëlqej në lavdinë tënde. (Psalmi 80:1)

## Plotësoret

Pas Hyrjes së Madhe, prifti i drejton njerëzit në një sërë kërkesash dhe lutjesh. Këto lutje fillojnë me një ftesë: “Le ta plotësojmë lutjen tonë ndaj Zotit”.

**ÇFARË TË BËNI?** Përgjigjuni me psaltin ose korin “Mëshiro, o Zot”, “Falna, o Zot”, “Ty, o Zot”.

**LUTUNI!** Thoni një lutje për njerëzit e përmendur në Litani.





# Besorja: Simboli i Besimit

Besorja është një pohim i asaj që besojmë si të krishterë. E themi atë bashkë, që të tregojmë që jemi të bashkuar në zemër dhe në mendje në ato që besojmë për Perëndinë. Pohimi bëhet në vetën e parë, numri njëjës, sepse duhet të jetë besimi personal i secilit prej nesh. Ne mund të dëgjojmë për besimin nga njerëz të tjerë, por është e rëndësishme që të vendosim personalisht për ta ndjekur Jisuin dhe të vendosim besimin tonë në Të. Pothuajse çdo pohim i Besores është nga Bibla. Të krishterët orthodhoksë duhet ta dinë përmendësh këtë pohim thelbësor të besimit.

## ÇFARË TË BËNI?


Qëndroni në këmbë kur thoni Besoren. Sipas traditës së hershme të krishterë, para Besores, çdokush përshëndet tjetrin me “puthjen e paqes”. Ata i thonë njëri-tjetrit: “Krishti midis nesh” dhe përgjigja është: “Ishte, është dhe do të jetë”.

“Puthja e paqes” është përmendur nga Shën Justin Martiri, që jetoi në shek. II. Në këtë moment të krishterët duhet të puthin njëri-tjetrin. Sot, shumica e njerëzve i japin dorën njëri-tjetrit, ndërsa pjesëtarët e familjes ose miqtë e ngushtë mund të shkëmbejnë “puthjen e paqes”. Ky pajtim midis njerëzve është një përgatitje e rëndësishme për pohimin e përbashkët të besës.

Lexoni Romakët 16:16, I Korintasve 16:20, 2 Korintasve 13:12, I Pjetri 5:14 që të shihni sesi apostujt mësuan të krishterët të përshëndetin njëri-tjetrin.

**VINI RE!** Gjatë thënies të Besores, prifti ngre mbulesat e Potirit dhe të Dhiskut.

**A E DINIT?** Besorja u shkrua në Sinodin I Ekumenik, në vitin 325 pas Krishtit dhe e plotësua në Sinodin II Ekumenik, në vitin 381 pas Krishtit. Ne e themi Besoren në çdo pagëzim, për të shpallur besimin e personit që do të pagëzohet. Nëse ai që do të pagëzohet është foshnjë, Besoren e thotë nuni.





# Besorja është biblike



Besoj në një Perëndi, Atë të Tërëfuqishëm.  
Krijues të qiellit dhe të dheut.  
Dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave.  
Dhe në një Zot Jisu Krishtin.  
Birin e Perëndisë të Vetëmlindurin.  
Që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve.  
Dritë prej Drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë,  
të lindur, jo të bërë.  
Që ka të qenët një me Atin,  
me anë të të cilit u bënë të gjitha.  
Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë,  
zbriti prej qiejve,  
dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë,  
dhe Virgjëreshës Mari,  
dhe u bë njeri.  
Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat,  
dhe pësoi dhe u varros,  
dhe u ngjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve,  
dhe u ngjit në qiejt,  
dhe rri në të djathtë të Atit,  
dhe do të vijë përsëri me lavdi,  
të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit,  
mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim.  
Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot,  
Jetëbërës,  
që buron prej Atit,  
që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin dhe Birin,  
që foli me anën e profetëve.  
Dhe në një Kishë të Shenjtë, Katholike dhe Apostolike.  
Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve.  
Pres ngjalljen e të vdekurve,  
dhe jetën e ardhshme të amshuar. Amin.

Zanafilla 17:1-8; Ligji i Përtërirë 6:4  
Zanafilla 1:1-31; Jobi 38:1-30  
Joani 1:3; Kolosianët 1:15 -16  
Joani 3:16, 20-28; Veprat e Apostujve 16:31  
Psalmi 2:7; Matheu 3:17; Joani 3:16  
Joani 1:1-2, 8:58; Kolosianët 1:16; Filipianët 2:6  
Joani 1:1-9; 16:27-28  
Joani 14:10-11; 17:22-23  
Joani 1:3-10; Kolosianët 1:16  
Lluka 2:30; Joani 3:16; I Joani 4:14; I Timoteut 2:5-6  
Joani 3:13, 31; Joani 6:12-38  
Lluka 1:35  
Isaia 7:14; Luka 1:35-46  
Joani 1:14; Filipianët 2:6-8; Hebrenjtë 2:14-17  
Mateu 27:24-31  
Marku 15:16-46  
I Korintasve 15:3-4; Lluka 24:1-12; Matheu 12:38-40  
Lluka 24:50-53; Marku 16:16-19  
Romakët 8:34; Efesianët 1:20  
Psalmi 72:9-19; Isaia 40:5  
Zbulesa 20:11-15; Veprat e Apostujve 10:42  
Psalmi 145:13; Joani 6:40-47  
Zanafilla 1:2; Matheu 3:16; Vep. Ap. 2:1-4  
Joani 15:26, 14:16-17; Romakët 8:2; Galatasve 6:8  
Joani 15:26  
Matheu 3:17; Lluka 10:22; Joani 4:24  
Veprat e Apostujve 2:17-18; 2 Pjetri 1:21  
I Kor. 12:12-13; Ef. 2:19-22; 2 Thesalonikasve 2:15  
Matheu 3:16; Joani 3:5; Vep. e Ap. 2:38, 8:36-40; Ef. 4:5  
I Korintasve 15:12-58  
Romakët 8:17-25; 2 Pjetri 3:13







## Anafora: Ofrimi i dhuratës sonë

**B**esorja na fut në pjesën më të rëndësishme të Liturgjisë Hyjnore: në ofrimin e dhuratave dhe në shenjtërimin e tyre. Ky proces quhet anafora. Shenjtërim do të thotë “një person ose një objekt vendoset mënjane për shërbesë hyjnore”. Në ofrimin e dhuratave, prifti i kërkon Perëndisë Atë të dërgojë Shpirtin e Shenjtë dhe ta ndryshojë bukën dhe verën në Trup dhe Gjak të Krishtit. Anafora është zemra e Liturgjisë Hyjnore.

Anafora është një dialog këndimi midis priftit dhe popullit. Lexoni thirrjet e priftit dhe përgjigjet e popullit. Pastaj prifti fillon një lutje të gjatë falënderuese për Perëndinë për gjithë gjërat e mrekullueshme që Ai bën për ne. Në lutje ai kujton fjalët e Krishtit në Darkën e Fundit, kur Ai mori bukë dhe verë, i bekoj dhe ua dha dishepujve të tij. Në fund, prifti ngre Potirin dhe Dhiskun, duke i ofruar Perëndisë bukën dhe verën. Ky moment është quajtur *epiklisis*, thirrje e Shpirtit të Shenjtë. Prifti lutet që Shpirti i Shenjtë të ndryshojë dhuratat në Trup dhe Gjak të Krishtit. Ne pastaj fillojmë të kujtojmë të gjithë njerëzit për të cilët janë ofruar dhuratat.

**ÇFARË TË BËNI?** Gjatë *epiklisis* shumica e njerëzve gjunjëzohen. Psaltët ose kori këndojnë himnin “Të himnojmë...”.

**DËGJONI!** Prifti e mbaron bekimin e bukës dhe të verës duke thënë: “Duke i ndryshuar ato më anë të Shpirtit tënd të Shenjtë”. Ndërsa ne mund të themi “Amin” (me zë të lartë ose me vete) pas bekimit të secilës prej tyre.

**LUTUNI!** Lutuni për të gjithë ata që janë larguar nga kjo jetë, jo vetëm për pjesëtarët e familjes, por edhe për martirët, etërit e kishës dhe profetët dhe veçanërisht për Hyjlindësen.

**A E DINIT?** Lutja e Anaforasë u shkrua nga shenjtori, Liturgjinë e të cilit kremtojmë.



# Lutja Zotërore

Dishepujt e Zotit i kërkuan atij: “Na mëso si të lutemi!” Jisui iu dha atyre lutjen që ne e quajmë Lutja Zotërore. Shihni fjalët e lutjes frazë pas fraze. Çfarë do të thonë ato?

**ÇFARË TË BËNI?** Qëndroni në këmbë kur thoni Lutjen Zotërore. Bëni shenjën e kryqit pasi prifti bekon njerëzit e mbledhur.

**A E DINIT?** Nga kohët e hershme, Lutja Zotërore u mësohej katikumenëve vetëm disa ditë para pagëzimit.

Ati ynë që je në qiell,  
u shenjtëroftë emri yt,  
ardhtë mbretëria jote,  
u bëftë dëshira jote  
si në qiell, ashtu edhe mbi dhe.  
Bukën tonë të përditshme  
jepna neve sot;  
dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne  
ua falim fajtorëve tanë;  
dhe mos na shtjer në ngasje,  
po shpëtona nga i ligu.

(Mattheu 6: 9-13; shih edhe Lluka 11: 2-4)



**Shën Jakovi**

- Liturgjia Hyjnore e shën Jakovit, apostullit dhe vëllait të Zotit, zhvillohet në ditën e festës së tij (23 Tetor).

**Shën Vasili i Madh**

- Celebrohet në vigjilje të Krishtlindjeve, në vigjilje të Theofanisë, ditën e festës së shenjtit (1 Janar), të dielat e Kreshmës së Madhe dhe Javën e Madhe.

**Shën Joan Gojarti**

- Celebrohet në shumicën e rasteve.

Tri Liturgjitë Hyjnore që kremtojmë rregullisht në Kishë mbajnë emrat e tre shenjtoreve që patën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre. Në ikonat e tyre ata tregohen duke mbajtur libra të Liturgjisë Hyjnore.



# Përgatitje për Kungim



**M**e bukën edhe verën tashmë të shenjtëruara në Trup dhe Gjak të Krishtit, fillon përgatitja përfundimtare për Kungimin e Shenjtë. Prifti këndon: “Të shenjtat, të shenjtëve”. Ne i përgjigjemi po me këndim: “Një është shenjt...”. A është kjo një përgjigje e përshtatshme?

Pas kësaj këndojmë himnin e Kungatës (Kungatoren). Gjatë himnit, buka e shenjtëruar thyhet në katër pjesë dhe rregullohet në Dhisk. Prifti vendos një nga katër pjesët në Potir dhe hedh një sasi të vogël uji të nxehtë në Potir. Më pas prifti lutet qetësisht që të përgatitë veten për të marrë Kungatën e Shenjtë. Pasi merr Kungimin e Shenjtë, duke pirë nga Potiri dhe duke ngrënë nga Dhisku, ai e vendos Bukën e shenjtëruar brenda në Potir, që Kungimi i Shenjtë t’u shpërndahet besimtarëve.

Si përgatiteni për të marrë Kungimin e Shenjtë? Tre pjesë të rëndësishme të jetës së krishterë janë: kreshma, lutja dhe lëmosha. Pyetni priftin e enorisë suaj për udhëzime mbi këto praktika dhe të tjera, veçanërisht çfarë të lexoni dhe si të rrëfehëni.

**VINI RE!** Prifti e ngre lart Bukën e shenjtëruar, Trupin e Krishtit.

**DËGJONI!** Kori këndon Kungatoren.

**ÇFARË TË BËNI?** Këndoni Kungatoren. Para se të merrni Kungatën e Shenjtë, mund të lexoni lutjet në librin tuaj të shërbesës, të cilat janë të njëjta me ato që lexon prifti.



# Marrja e

## Kungatës së Shenjtë



**ÇFARË TË BËNI?** Kur është koha për të marrë Kungimin e Shenjtë, me qetësi dhe me respekt hyni në radhë. Bëni shenjen e kryqit para se të arrini te Potiri. Kur të afroheni para Potirit i thoni priftit emrin tuaj të pagëzimit.

**A E DINIT?** Darka Mistike u themelua nga vet Krishti në Darkën e Tij të Fundit me dishepujt, kur mori bukë dhe verë, i bekoj dhe i ndau me dishepujt, duke thënë: “Ky është Trupi im dhe ky është Gjaku im”.

### SHKRIMI I SHENJTË

Pastaj Jisui u tha atyre “Me të vërtetë po ju them: nëse nuk hani mishin e Birit të njeriut dhe nuk pini gjakun e tij, ju nuk keni jetë. Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, ka jetë të amshuar dhe unë do ta ngjall në ditën e fundit, sepse mishi im është ushqim i vërtetë dhe gjaku im, pije e vërtetë. Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, mbetet në mua dhe unë në të”. (Joani 6: 53-57)



Në Kishën Orthodhokse, Kungimi i Shenjtë u jepet vetëm të krishterëve orthodhoksë. Të krishterëve jo orthodhoksë nuk u ofrohet Kungimi i Shenjtë. Kjo është një pasojë e trishtueshme dhe e dhimbshme e ndarjeve që ekzistojnë brenda Krishterimit. Jo orthodhoksët nuk mund të kungohen, sepse ne besojmë se marrja e Kungimit të Shenjtë është vepër e komunitetit që ndan një besim, një jetë, një adhurim. Marrja e Kungimit nga të krishterët që nuk janë të bashkuar me ne, nënkupton një unitet, që në realitet nuk ekziston ende. Duke pasur parasysh lutjen e Krishtit për dishepujt e Tij “që ata të jenë një” (Joani 17:21), ne lutemi që këto ndarje të zvogëlohen dhe përfundimisht të zhduken.





# Litania e Falënderimit



**P**asi marrim Kungimin e Shenjtë, jemi shumë mirënjohës. Prandaj Kungimi pasohet nga himni ose lutja e falënderimit: “Pamë dritën e vërtetë...”. Lexoni himnin. Cili është besimi i vërtetë për të cilin himni thotë që falënderojmë? Lexoni lutjen që pason himnin. Për çfarë lutemi aty?

**ÇFARË TË BËNI?** Këndoni me psaltët ose me korin.

**DËGJONI!** Cilët shenjtorë ose grupe shenjtorësh përmenden në përlëshoren e fundit?

**LUTUNI!** Thoni një lutje falënderimi për Perëndinë.

## Lutjet e mbylljes

Në fund të Liturgjisë Hyjnore, prifti thotë një kërkesë të fundit për bekimet e Perëndisë për pjesëtarët e komunitetit. Lexoni lutjen. Çfarë kërkon prifti nga Perëndia? Pasi ka mbaruar Liturgjia, secili vjen përpara që të marrë një pjesë anafore nga prifti.

**LUTUNI!** Lutuni qetësisht bashkë me priftin. Mendoni për dikë që ka nevojë për lutje, ndërkohë që ai përmend klerikët, autoritetet civile dhe të tjerët.

**DËGJONI!** Përpiquni të mësoni himnin e shkurtër që këndon kori.

**A E DINI?** Në kohët e hershme, të gjithë njerëzit dilnin nga kisha duke kënduar “Emri i Zotit qoftë i bekuar”.





# Pas Liturgjisë

**L**iturgjia Hyjnore ka shumë urdhërime dhe e fundit është: “Me paqe le të shkojmë”. Mbarimi i Liturgjisë Hyjnore, nuk është përfundimi, por fillimi. Çfarë do të thotë kjo? Pas veprës hyjnore, Liturgjisë, ne njerëzit kemi punë të tjera për të bërë. Gjatë Liturgjisë adhurojmë Perëndinë dhe i lutemi Atij për të tjerët. Pas kësaj, duhet të vazhdojmë punën dhe të tregojmë që Liturgjia ka prekur jetën tonë. “Me paqe le të shkojmë”, është një thirrje për ne, që të përmirësojmë veten, t’i shërbejmë botës rreth nesh dhe t’u tregojmë të gjithëve për Lajmin e Mirë të Jisu Krishtit. Gjithë kjo ide përmbledhet në shprehjen “Liturgji pas Liturgjisë”. Tani kjo shprehje përdoret në mbarë botën orthodhokse. Ajo u prezantua për herë të parë nga Kreypiskopi Anastas, në fillimet e punës së tij misionare.



Qielli në tokë: Liturgjia Hyjnore

Botuar nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Zyra Qendrore e Fëmijëve

Rruga e Kavajës, nr.151, Tiranë, Shqipëri

Falënderime të veçanta për Departamentin e Edukimit të Krishterë të Kryedioqezës Orthodhokse Greke në Amerikë, që na dha të drejtën për të përdorur këtë material.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Teksti: Tom Papagiannis

Teksti shtesë: Anton Vrame, PhD  
dhe Aimee Cox Ehrns

Arti grafik: Dionne Katinas

Përktheu: Gabriela (Alketa) Dalipi

Redaktoi: Ana (Anila) Baba



